



Art-Auditing , për të ndërtuar besimin!

Rruga Artan Lenja,
Kompleksi Magnet, Tiranë
Email: merilika@outlook.com
Tel: 069 20 24 448

Nr 0811/23 prot

Tiranë më 08 Nëntor 2023

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Lënda: Informacion

Të nderuar përfaqësues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në zbatim të misionit tim, caktuar me vendimin Nr. 544 datë 22.05.2023, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe sipas kontratës nr. 7006 datë 27.09.2023, të lidhur mes nesh ju informoj se, nga lista e 15 partive për të cilat jam përzgjedhur t'iu auditoj pasqyrat financiare të vitit 2022, për partitë e listuara më poshtë nuk ka qenë i mundur auditimi për arsytet si vijon:

A. Nuk kanë adresë

1. Partia Ideali Demokratik Shqiptar
2. Partia Drejtësia Shoqërore

Në lidhje me këto subjekte adresat postare kanë qenë të paplota dhe Posta Shqiptare nuk ka pranuar të dërgojë njoftim. Partia Ideali Demokratik Shqiptar ka adresë :Shkodër, kurse Partia Drejtësia Shoqërore ka adresë: Tiranë.

B. Nuk janë gjetur në adresë

1. Partia Aleanca për Europën
2. Partia Uniteti Kombëtar
3. Partia Demokratike e Bashkimit Myslyman të Shqipërisë
4. Partia Rruga e Vërtetë Shqiptare
5. Partia e Çështjeve Shqiptare
6. Partia Aleanca Socialiste Shqiptare
7. Partia Demokracia e Re e Djathtë Shqiptare
8. Partia Lëvizja për të Drejtat e Njeriut

Në lidhje me këto subjekte janë dërguar njoftime dhe janë kthyer pas për adresë të pasaktë ose ndërrim adrese (procedurë kjo e ndjekur nga kolegët e mi në vitet e mëparshme dhe ku është marrë e njëjta përgjigje).

Art – Auditing
Rruga Artan Lenja, Kompleksi Magnet, Nr.2024, Tiranë
Mail: merilika@outlook.com Tel: 069 20 24 448

Për subjektin Partia Lëvizja për të Drejtat e Njeriut kam dërguar njoftimin i cili është kthyer nga posta me arsyen "Larguar".

C. Nuk kanë hartuar pasqyra financiare për vitin 2022

1. Partia Mendimi i Djathtë Liberal.

Në lidhje me këtë subjekt nuk është bërë i mundur auditimi për arsye se nuk ka të dorëzuara pranë KQZ-së pasqyra financiare, por vetëm një deklaratë. Për këtë subjekt është kontaktuar në telefon kryetarja znj. Amina Lici, së cilës i është komunikuar që nuk ka paraqitur pasqyra financiare dhe ajo ka konfirmuar që do të komunikonte me KQZ, kam tentuar ta kontaktoj sërish por nuk më është bërë e mundur dhe në faqen zyrtare të KQZ-së edhe nuk janë depozituar pasqyrat financiare.

D. Subjekte pasive

1. Partia Ardhmëria Shqiptare
2. Partia Lëvizja për Ndryshim

Në lidhje me këto subjekte sqarojë se edhe pse këto subjekte kanë dorëzuar pasqyra financiare për vitin 2022, por në sistemin tatimor këto subjekte janë me status PASIV¹.

Bazuar në nenin 44, pika 7, të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar në të cilin theksohet si citoj:

"Çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, që janë në regjistrin pasiv, konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet në përputhje me këtë ligj"

Pra për këto dy subjekte është i pamundur që t'iu faturohet shërbimi i adutimit.

Audituese Ligjore



¹ <https://www.tatime.gov.al/c/8/129/132/subjekte-pasive>

Art – Auditing

Rruga Artan Lenja, Kompleksi Magnet, Nr.2024, Tiranë

Mail: merilika@hotmail.com Tel: 069 20 24 448

